



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.766/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi -kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.766/2022 të datës 05.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin kundër organit të punësimit Komuna e Decanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.766/2022 e datës 05.09.2022 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Anullohet procedura e pranimit sipas Konkursit më numër reference RN00009154 për grup pozitash “Specialistë të Ekonomisë-Zyrtar i Pasurisë, e shpallur me datë 03.06.2022 nga Komuna e Deçanit si dhe çdo veprim që rrjedhë nga kjo procedurë pranimi.**
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Deçanit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datë 05.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5130/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me shenjë Nr.02/zyrtarisht të datës 23.08.2022 të Komisionit për Pranim të Komunës së Deçanit, me pretendimi se Konkursi RN00009154 i datës 03.06.2022, është përcjell më parregullsi gjatë vlerësimit me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Deçanit, ndërsa kjo e fundit më datë 14.09.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5130/2022 të datës 05.09.2022; Vendimin me Nr.02/Zyrtarisht të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5186/2022 të datës 06.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5387/2022 të datës 14.09.2022; Konkursin me numër të referencës RN00009154 të datës 03.06.2022; Vendimin me numër 02/Zyrtarisht të datës 14.07.2022; Vendimin me Nr.02/Zyrtarisht të datës 14.07.2022 lidhur me Emërimin e Komisionit për Vlerësimin e Pranimin në Shërbim Civil dhe Zhvillimin e Procedurave Rekrutuese për Pozitën e Punës " Zyrtar i Pasurisë" në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa; Njoftimin me numër RN.00009154 të datës 07.07.2022 të Menaxherit të Personelit në Komunën e Deçanit lidhur me Njoftimin për përfshirjen në listën e ngushtë; Listën e aplikantëve të pranuar dhe të refuzuar me numër të referencës RN00009154 (pa datë); Njoftimin e datës 07.07.2022 me numër RN00009154 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë të kandidatës [redacted] Njoftimin e datës 07.07.2022 me numër RN00009154 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë të kandidatës [redacted] Njoftimin e datës 07.07.2022 me numër RN00009154 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë të kandidatës [redacted] Njoftimin e datës 07.07.2022 me numër RN00009154 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë të kandidatës [redacted] Renditjen përfundimtare me numër RN.00009154 të datës 18.08.2022; Dosjen e ankuesit Aplikacionin me Nr. reference RN00009154 të datës 29.06.2022; Dokumentin e identifikimit; Diplomën e datës 18.12.2006 me anë të cilës mori titullin Bachelor i administrimit të Biznesit; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Strategjia e Shitjes" për periudhën kohore Prill-2017; Certifikatën e datës 21.12.2015, lidhur me përfundimin e provimeve në Institutin për Kontabilitet Auditim dhe Financa (IKAF); Certifikatën e datës 01.10.2012 lidhur me përfundimin e trajnimit "Credit Registry Softëare"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Introduction to Microfinance Trajning Course" për periudhën kohore 22-26.09.2010; Letër referencën e datës 01.08.2011; Vërtetimin e datës 19.12.2012; Letër referencën 30.06.2017; Dosjen e kandidatit [redacted] Dokumentin e identifikimit; Aplikacionin me numër Reference RN00009154 të datës 29.06.2022; Diplomën Nr.0164 të datës 19.12.2012 me të cilin kandidati fitoj

titullin Bachelor i Shkencave Administrim dhe Biznes; Diplomën me numer.2586/20 të datës 15.12.2020 me të cilën kandidati mori titullin Master i Arteve në Marketing dhe Menaxhim Biznesi; Dëshmi lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze nga data 01.03.2006 deri me 27.07.2010; Certifikatën e datës 01.07.2007; Certifikatën lidhur me përfundimin e praktikës në kontabilitet për periudhën kohore 17.09.2013 deri më 17.12.2013; Vërtetimin e datës 15.04.2022, lidhur me përvojën e punës " Piano Cafe". Certifikatën nga Evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë e datës 14.06.202: Dosjen e kandidatës Dokumentin e identifikimi: Aplikacionin me numër RN00009154 datës 30.06.2022: Diplomën e datës 29.09.2016 me të cilën morri titullin Bachelor Banka dhe Financa në Biznes; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës për kontratën për Shërbime të Veçanta për periudhën kohore 01.06.2018 deri me datën 31.05.2020; Vërtetimin Nr.2173 të datës 06.07.2016 lidhur me përfundimin e punës-praktike në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës; Dosja e kandidatit Aplikacionin me numër të Referencës: RN00009154 të datës 28.06.2022; Dokumentin e identifikimit; Diplomën e datës 16.12.2016 me të cilën kandidati ka fituar titullin Master i Arteve në Menaxhment dhe Informatikë; Certifikatën e datës 05.11.2021 lidhur me përfundimin e trajnimit " Ndërmarrësi dhe Vetëpunësim"; Certifikatën e datës 01.02.2019 lidhur me përfundimin e trajnimit "Zhvillim të kapaciteteve-Ndërmarrësi"; Certifikatën e datës 25.11.2014 lidhur me përfundimin e trajnimit për Ndërmarrësi dhe Hartimin e Olanit të Biznesit"; Certifikatën lidhur me përfundimin e "School of Entrepreneurship"; Certifikatën e datës 02.12.2012 lidhur me përfundimin e kursit "Ndërmarrësi"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Entrepreneurship, Marketing Financial Planning and Business Planning" për periudhën kohore Tetor-Nëntor, 2012; Certifikatën Nr.258/2013 të datës 15.03.2013 lidhur me përfundimin e kursit " Administrim Biznesi"; Vërtetimin e datës 14.04.2017 lidhur me përvojën e punës në N.T.P " Egzoni"; Vërtetimin me numër 20683 të datës 21.06.2022 lidhur me përvojën e punës për periudhën kohore 02.05.2017 deri me datën 31.03.2022 në Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Muze"; Vërtetimin me numër 20684 të datës 21.06.2022 lidhur me përvojën e punës në Drejtorin për Buxhet dhe Financa për Pasuri pranë Komunës së Deçanit; Referencës me numër 48 të datës 05.03.2012; Dosja e kandidatit Aplikacionin me numër të referencës RN00009154 të datës 29.06.2022; Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 2415 të datës 05.02.2014 me të cilën kandidati ka fituar titullin Bachelor i Drejtësisë; Dëshminë lidhur me përvojën e punës të datës 29.06.2022, për periudhën kohore 01.01.2018 deri me datën 01.12.2021; Dosjen e kandidatit Aplikacionin me numër të referencës RN00009154 të datës 01.07.2022 ; Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 623 të datës 03.11.2016 me të cilën kandidati ka marr titullin Bachelore i Agro Ekonomisë; Vërtetimin me numër LRP. Nr.3992/2021 lidhur me motorizimin e dokumenteve; Diplomën me Nr. 171 të datës 15.03.2017 me të cilën kandidati morri titullin Master i Shkencave në Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit; Vërtetimin me numër LRP.Nr.3985/2021 lidhur me noterizimin e dokumenteve; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Mbi praktikat e mira bujqësore" Prill, 2016; Certifikatën e datës 19.01.2017 lidhur me përfundimin e trajnimit "Production, processing and commercial promotion of medical herbs and forest-groen products"; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit "SPSS Basic" për periudhën kohore 01.02.2017 deri me 25.02.2017; Certifikatën me numër Std.nr. 487/04 të datës 31.07.2019; Vendimin me numër 256 /1 të datës 28.10.2018 lidhur me përvojën e punës; Vërtetimin e datës 05.11.2020 lidhur me përvojën e punës në SHPK " Biosource" ; Njoftimin me numër 02/ Zyrtarisht të datës 19.08.2022 për Kandidatin e suksesshëm; Emalin e datës 21.07.2022 të E.Cacaj drejtuar kandidateve lidhur me Njoftimin për mbajtjen e

testit me shkrim; Emalin e datës 20.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 18.07.2022 drejtuar Emalin me numër të protokollit 5469/2022 të datës 16.09.2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; Emalin e datës 07.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 07.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, drejtuar Kërkesën për informata zyrtar për Komunën e Deçanit e datës 19.10.2022 dhe Përgjigjen e datës 19.10.2022, e-mail i datës 19.10.2022 nga për Këshillin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankues është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së Komuna e Deçanit me datë 03.06.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00009154, për grupin e punës "Specialist të Ekonomisë-Zyrtar i Pasurisë", klasa e pozitës profesionale 2, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi duke u përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Sipas Renditjes Përfundimtare të kandidatëve të datës 18.08.2022, kandidati është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë gjithsej 79.6 pikë duke u renditur si kandidati i parë në listë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 75.6 pikë duke u renditur si kandidati i dytë.

Ankuesi i pakënaqur me renditjen përfundimtare, parashtron ankesë pranë Komisionit të Pranimit, i cili me Vendimin me shenjë 02/Zyrtarisht të datës 23.08.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar. Kundër këtij vendimi ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin së Konkursi me numër reference RN00009154, për pozitën e punës Zyrtar i Pasurisë është përcjell më parregullsi në vlerësimin e testit me shkrim, duke shtuar së njeri nga anëtarët e Komisionit të Pranimit gjatë testit me shkrim ka ndihmuar në përgjigje kandidatin fitues, ku për vërtetimin e këtij fakti ka kërkuar që Këshilli ta siguroj incizimet përmes kamerave të sallës së testimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me pretendimin e ankuesit që të sigurohen incizimet nga kamerat e sallës së testimit për vërtetim të faktit se ka pas parregullsi gjatë testimit rrjedhimisht se njëri nga anëtarët e Komisionit të Pranimit ka ndihmuar në përgjigje kandidatin e suksesshëm, ka kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nëse salla e testimit monitorohet nga kamerat, ndërsa DMZP-ja përmes njoftimit me shkrim të datës 16.09.2022 ka informuar Këshillin së salla e testimit elektronik, përkatësisht salla nr.015, nuk monitorohet me kamera, adaj nisur nga kjo, Kolegji në mungesë të provave nuk ka mundur të provoj pretendimin e ankuesit se ka pas parregullsi në procedurën e testimit me shkrim.

Sipas Konkursit me numër reference RN00009154, për grupin e punës "Specialist të Ekonomisë-Zyrtar i Pasurisë" si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Përvoja e punës; së paku dy vite përvojë pune në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*".

Kolegji në kuptim të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka vlerësuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me numër reference RN00009154, për grupin e punës "Specialist të Ekonomisë-Zyrtar i Pasurisë, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Kolegji ju referua Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku me

shtojcën Nr.1/9 lidhur me klasën Profesional 2 si kërkesat të përgjithshme formale janë përcaktuar: a) *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.* b) *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.* c) *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, ndërsa tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 4, si kritere për fushën e kërkuar të arsimit për grupin e punës "Specialistë të Ekonomisë" është përcaktuar **Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti).** Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë, Kolegji konstaton së sipas Konkursit me numër reference RN00009154 për emrin e grupit *Specialistë të Ekonomisë*, nuk është specifikuar fusha e arsimit për pozitën e shpallur, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se mos përfshirja e fushës së arsimit është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Përkatësisht mos specifikimi i fushës së arsimit për pozitën e shpallur, ka sjell ekzistimin e rrethanave të trajtimit jo të barabartë dhe diskriminues të kandidatëve E. Kamberaj, dhe të ankuesit në raport me kandidatin e zgjedhur pasi që kandidatet tjerë kanë plotësuar kriterin e arsimit të përcaktuar me Rregulloren QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pasi që të njëjtit posedojnë diplomë bechelor për përfundim të programeve të fakultetit ekonomik ndërsa sipas provave të lëndës kandidatja e përzgjedhur posedon diplomë bechelor për përfundim të fakultetit juridik.*

Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidateve të përfshirë në listën e ngushtë, ka gjetur se njësia përgjegjëse nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike sepse bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas dëshmive të dorëzuara nga kandidate me rastin e aplikimit, është konstatuar se kandidati në këtë rast ankuesi, lidhur me përvojën e punës ka prezantuar Vërtetimin e datës 19.12.2012 të lëshuar nga Udhëheqësja e BNJ të KEP, si dhe Letër Referencën e datës 30.06.20217 nga Menaxherja e BNJ të Agjencinë për Financim në Kosovës, Kandidati D. Balaj lidhur me përvojën e punës ka ofruar Vërtetimin e datës 15.04.2022 të lëshuar nga pronari i biznesit "Piano Cafe", kandidati V. Tahiri j lidhur me përvojën e punës ka ofruar Vërtetimin e datës 05.11.2020 të lëshuar Drejtori i Kompanisë SHPK "BIOSOURCE", rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit si dhe duke u bazuar edhe në konstatimin e Gjykatës së Apelit sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, vërtetimi dhe referenca lidhur me përvojën e punës në sektorin privat nuk janë dëshmi të mjaftueshme dhe të vlefshme për të provuar faktin e përvojës së punës pasi që të njëjtat nuk janë të shoqëruara me vërtetim nga organet përgjegjëse gjegjësisht Administrata Tatimore dhe Fondi i Kursimeve Pensioneve.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të Vendimit me shenjën Nr.02/Zyrtarisht të datës 14.07.2022, për emërimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil, ka gjetur se në këtë vendim nuk janë përshkruar pozitën e anëtarëve të këtij komisioni si dhe zëvendësuesve, ndërsa sipas emailit të datës 19.10.2022 të përcjell nga Komuna e Deçanit është konfirmuar së asnjëri nga anëtarët e Komisionit të Pranimit nuk është nga Njësia e Burimeve Njerëzore. Bazuar në këtë fakt Kolegji i Këshillit konstaton së Komisioni i Pranimit është emëruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: "Komisioni i Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin;e në këtë kuptim sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë,

Njësi përgjegjëse për institucionet e tjera shtetërore është Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit gjegjes.

Andaj, meqë janë evidentuar shkelje ligjore gjatë zhvillimit të procedurës së pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00009154, për grupin e punës "Specialist të Ekonomisë-Zyrtar i Pasurisë", Kolegji në kuptim të nenin 52 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave procedurale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda.A.nr.766/2022.

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.